

E ENJTE DATA 15 QERSHOR 2023

Dëgjova zonjën të fliste për DAP-in, trajnimet e DAP-it, për administratën publike në përgjithësi, për kurse, për shpenzime. Zonjë, koncepti “administratë publike” në Shqipëri është pushkatuar që kur ka ardhur në pushtet kjo farë e keqe e Rilindjes. Zonjë, ti nuk ke lidhje me administratën publike, por je një militante e përdorur dhe e keqpërdorur. Edhe kur ke qenë zëvendësministre e Shëndetësisë, edhe tani, vetëm je keqpërdorur për të bërë afera, kurse për çështje politike as ti dhe as Kryeministri yt nuk u keni shërbyer asnjë sekondë shtetit, qytetarëve dhe ligjeve të këtij vendi. Ndaj, mos ua thoni këto dokrra shqiptarëve! Po, në forumet e partisë suaj mund të bëni hartime, citime, recitime dhe tregoni përralla. Ju vidhni, se vetëm atë dini të bëni, nuk dini gjë tjetër, kurse për administratën publike mos flisni. Aplikacioni “Aktivisti”, që ju ... Më falni, që po jua them, por duhet të kesh guxim të tejskajshëm të thuash para shqiptarëve dhe para gjithë deputetëve që aplikacionin e kanë plotësuar vetëm socialistët dhe jo administrata, ndërkohë që ne kemi mijëra raste kur administrata është terrorizuar dhe kërcënuar për të plotësuar aplikacionin kriminal të “Rilindjes”, i quajtur “Aktivisti”, edhe pse si patronazhistët, ashtu edhe aplikacionin “Aktivisti” e kanë denoncuar institucionet ndërkombëtare, zonjë! Ju nuk keni fytyrë! Çfarë t’ju them unë!? Ju dilni fare pa turp këtu dhe mundoheni të na mbushni mendjen jo vetëm neve, por edhe të gjithë shqiptarëve, që e zeza është e bardhë. Pastaj, brenda pak minutash dilni përsëri këtu dhe thoni që e bardha është e zezë!

Ndjesë, këtë eskalim të këtyre limiteve ne nuk e njohim dhe mbase prandaj nuk ju kuptojmë, por raporti i ODIHR-it, zonjë, thotë se janë shpërdoruar burimet njerëzore të administratës, është bërë presion mbi administratën dhe mbi votuesit e rrethit familjar të punonjësve të administratës. Çfarë është kjo? Vetëm opozita e thotë këtë? E thotë ODIHR-i. Zonjë, ju nuk keni ndjeshmëri ndaj kësaj! Këtë e thotë edhe Parlamenti European në rezolutën për patronazhistët, por ju nuk keni ndjeshmëri. Ju keni ndjeshmëri vetëm për çfarë ju thotë “babloku”. Sulltan Surreli ju thotë dhe ju hyxhym përpara: s’ka ligj, s’ka Maliq, s’ka asgjë, rroftë Sulltani; çmendurira thoni, as skuqeni, as zverdheni. Zonjë, shikojeni pak këtë! Kjo këtu është ministrja në fushatë. Qendra shëndetësore “Bregu i lumit” i ka bërë share dhe like ministres në fushatë. Drejtuesi i kësaj qendre çfarë është? Spitali bashkiak i Delvinës i bën share dhe like ministres tënde në fushatë. Çfarë është kjo? Zëvendësdrejtori gjeneral i Operatorit të Shpërndarjes, Makens Shllaku, se është edhe me emër këtu, i bën share dhe like. A është administratë kjo, apo jo? Po Besart Mataj është pjesë e administratës publike? Edhe ai i bën share dhe like. Këtu kam edhe disa të tjera, si: qendra shëndetësore në Bërxullë, njësia vendore e kujdesit shëndetësor në Durrës, spitali bashkiak i Delvinës. Vazhdojmë me të tjera. Mirela Cami, operatore e Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor, i bën share dhe like, zonjë. Ti, zonja Ministre, të lutem mos ndërhy kur flas unë! I ke të gjitha këtu. Njësia administrative në Sult, po ashtu.

Të gjithë janë pjesë e administratës publike. Ndaj mos flisni më për administratë publike, mos flisni më për përralla, për shpenzime parash dhe për vjedhje parash, sepse e keni shndërruar administratën në një strukturë militantësh partie, e keni vrarë administratën publike dhe keni bërë gjithçka për ta shndërruar në një organizatë kriminale, në funksion të “Rilindjes”, sikundër jeni edhe ju. Ndaj, të paktën kursejani këto shqiptarëve, njëri-tjetrit thojani, sepse jeni të ngjashëm dhe jeni njëlloj, por pafytyrësinë, mashtrimin, hajdutërinë, babëzinë dhe kriminalitetin nuk ua pranojnë shqiptarët.